



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Në datën 25. 11. 2016 Mekanizmi Parandalues Nacional (MPN) realizoi vizitë të pa paralajmëruar në Stacionin Policor Tetovë (vizita paraprake e ekipit të MPN në këtë stacion policor është realizuar në datën 31. 10. 2011).

Vizita në SP Tetovë rezulton nga mandati i Avokatit të Popullit – Mekanizmi Parandalues Nacional, si dhe parashikohet në Protokollin Fakultativ të Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese ose Ndëshkuese. Me Protokollin Fakultativ përcaktohet zbatimi i vizitave të rregullta në vendet ku personat mund të privohen nga liria, me qëllim të identifikimit të rreziqeve dhe parandalimit të torturës ose llojeve tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues.

Avokati i Popullit – ekipi i MPN, u shoqërua nga përfaqësuesi i Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj dhe përfaqësuesi i Shoqatës për të Drejtë Penale dhe Kriminologji të Republikës së Maqedonisë, në cilësinë e bashkëpunëtorëve të jashtëm.

Nga këqyrja e kryer në zyrat e nëpunësve të SP Tetovë, ekipi i Mekanizmit Parandalues Nacional konstatoi se hapësirat janë rinovuar, se të njëjtat janë në gjendje të mirë dhe se nuk vërehet prezenca e lagështisë. Në hapësirat ku zhvillohet marrja në pyetje e personave janë siguruar karrige dhe inventar tjetër, të nevojshme në rast të prezencës së personit të tretë, krahas personave zyrtarë. Në hapësirat në të cilat janë kryer këqyre nuk u vërejtën mjete ose sende me të cilat do të mund të kryhej frikësimi ose keqtrajtimi.

Në momentin e vizitës të Stacionit Policor Tetovë nuk kishte persona të ndaluar, e as të arrestuar, me të cilët ekipi i MPN do të mund të bisedonte lidhur me trajtimin e tyre nga ana e nëpunësve policorë, si dhe me kushtet e ndalimit në këtë stacion policor.

Stacioni Policor Tetovë është përfshirë me Projektin për rinovimin e vendeve të ndalimit të personave të privuar nga liria, të cilin e zbaton Ministria e Punëve të Brendshme dhe i cili financiarisht mbështetet nga Komisioni Evropian. Në kuadër të

stacionit policor ka 3 hapësira të reja për ndalim, nga të cilat 2 janë individuale dhe një është kolektive me 2 krevate.

Për këtë vizitë, Mekanizmi Parandalues Nacional hartoi raport të veçantë në të cilin i konstatoi gjendjet pozitive dhe negative dhe dha rekomandime konkrete të cilat ia dërgoi Ministrisë së Punëve të Brendshme, si dhe komandantit të Stacionit Policor Tetovë, me qëllim që të eliminohen mangësitë e vërejtura dhe të përmirësohen kushtet dhe trajtimi i personave të privuar nga liria, si dhe personave të arrestuar dhe të ndaluar.